

VENDIM
Nr.487, datë 17.7.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “SYNEJ”
SUBJEKTIT FIZIK: GRAMAZ ISMAILI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.375, datë 30.11.2005, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.03.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televisionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit fizik, z.Gramaz Ismaili, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televisionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës, për të penetruar në komunën Synej-Kavajë.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e saj, ku përfshihen struktura programe, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj